

VENDIM
Nr. 19, datë 16.3.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR THIRRJEN E DYTË PËR NËNPROGRAMIN
E ARSIMIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 11, DATË 25.2.2015**

(Ndryshuar me vendimin nr. 37, datë 28.7.2015; nr. 44, datë 27.11.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të nënprogramit të arsimit (arsimi bazë dhe i mesëm), pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, në vlerën 197 126 815 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin pranë Sekretariatit Teknik për Arsimin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik e të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fund të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe për të rishpërndarë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet Sekretariati Teknik për Arsimin, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje në pikën 3, të këtij vendimi.

5. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhëj vendimit nr. 11, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për arsimin, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, në nënprogramin e arsimit, nga FZHR 2015

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera e plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)
		QARKU FIER				
1	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme 18 Tetori, Bashkia Lushnje	9230	53,141,487	26,570,744	26,570,743
		FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT*				
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar "Caush Senja" Tunje, Komuna Tunje	9230	6,494,161	3,247,081	3,247,080
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Fshati Sheq Musalalaj, Komuna Frakull	9120	32,543,699	16,271,850	16,271,849
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare fshati Toshkës, Komuna Allkaj, Lushnje	9120	38,497,556	19,248,778	19,248,778
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Dersnik, Komuna Voskop	9120	12,173,171	6,086,586	6,086,585
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shkollës së mesme Farkë e Madhe, Tiranë, Komuna Farkë	9230	252,467,306	125,701,776	126,765,530
TOTALI				395,317,380	197,126,815	198,190,565

* Në zbatim të vendimit të KZHR nr.6, datë 9.2.2015, "Për administrimin "tranzitor" të projekteve me autoritet kontraktues komunat, për periudhën shkurt-shtator 2015".

Shënim:

1. "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2016.

Tabela 2. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhjet vendimit nr.11, datë 25.02.2015

Projektit nr.9 i ndryshohet emërtimi si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi	Vlera plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)
		QARKU KORÇË				
9	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Stavri Themeli"	09120	49,999,496	24,999,748	24,999,748

(Ndryshuar tabela nr. 1 sipas tabelës së mëposhtëme me vendimin nr. 37, datë 28.7.2015)

Tabela 1.

Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhjet vendimit nr. 19, datë 16.3.2015

Projektit nr. 6, i ndryshon vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, si dhe totalët e tabelës, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Kodi i programit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU TIRANË						
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shkollës së mesme, Farkë e Madhe, Tiranë	9230	252,467,306	25,701,776	226,765,530
TOTALI				395,317,380	97,126,815	298,190,565

(Ndryshuar tabela nr. 1 me vendimin nr. 44, datë 27.11.2015)

Tabela 1. Lista e projekteve të arsimit, me reduktim apo shtesë financimi për 2015, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e Financimit të miratuar për vitin 2015 (Lekë)	Fonde që i reduktohen financimit të vitit 2015 (Lekë)	Fonde që i shtohen financimit të vitit 2015 (Lekë)
QARKU BERAT							
1	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksion i kopshtit qendër Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore	26,705,933	24,254,944	13,352,967		10,901,977
2	Bashkia Ura Vajgurore	Sistemim, rrethim oborri, ndërtim palestere Shkolla e Bashkuar, Lagja "4 Shtatori", Ura Vajgurore	35,160,733	24,317,111	12,833,620		11,483,491
QARKU DURRËS							
3	Bashkia Krujë	Rikonstruksioni i shkolles se mesme "Skenderbej" Kruje, (sistem ngrohje, sistemime te jashtme, terrene)	25,696,275	25,501,820	12,848,138		12,653,682
QARKU ELBASAN							
4	Bashkia Cërrik	Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9vjeçare "7Marsi" Bashkia Cërrik	51,517,643	51,300,000	25,758,822		25,541,178
5	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i palestrës së gjimnazit "Shefqet Buzi", Bashkia Gramsh	3,244,751	3,000,000	2,134,834		865,166
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar "Caush Senja" Tunjë, Komuna Tunjë	6,494,161		3,247,081	3,247,081	
QARKU FIER							
7	Bashkia Divjakë	Ndërtim i palestrës, terrene, sportive, rikualifikimi i hyrjes, ana perëndimore dhe muri rrethues së shkollës së mesme "Miti Zoi Zaka"	67,144,140	63,580,018	33,572,070	25,000,000	
8	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion i kopshtit dhe palestrës në shkollën "Koli Sako", Bashkia Divjakë	59,941,649	42,591,146	29,970,825	15,000,000	
9	Bashkia Fier	Rikonstruksioni i shkollës së mesme publike "Janaq Kilica"	46,851,701	27,165,114	23,425,851		3,739,263
10	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion shkolla e mesme e përgjithshme "18 Tetori", Bashkia Lushnje	53,141,487		26,570,744	12,000,000	
11	Fondi	Rikonstruksion i shkollës					

	Shqiptar i Zhvillimit	9vjeçare fshati Toshkës, Komuna Allkaj, Lushnje	38,497,556	25,637,395	19,248,778		6,388,617
	QARKU KORÇË						
12	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Stavri Themeli"	49,999,496	43,113,677	24,999,748		18,113,929
	QARKU LEZHË						
13	Bashkia Laç	Rikonstruksioni i Kopshtit nr. 1 në Bashkinë Laç (dy kate)	40,607,035	40,440,138	20,303,518		20,136,620
14	Bashkia Lezhë	Rikonstruksioni i sallës së qendrës kulturore fëmijëve	9,575,174	6,436,086	5,300,044		1,136,042
	QARKU SHKODËR						
15	Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i shkollës 9vjeçare "Xheladin Fishta"	22,468,458	14,586,532	11,234,229		3,352,303
	QARKU TIRANË						
16	Bashkia Kavajë	Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.2, tek ish rezervat e shtetit, Kavajë	23,165,934	20,692,401	11,582,967		9,109,434
17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shkollës së mesme Farkë e Madhe, Tiranë, Komuna Farkë	252,467,306		25,701,776	25,701,776	
18	Universiteti i Arteve	Rikonstruksion i sallës së lëvizjes skenike dhe pajisja me mjete e pajisje mësimore, mbështetëse	30,388,176		15,194,088	5,000,000	
	QARKU VLORË						
19	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja", Bashkia Vlorë	60,789,733	60,634,039	30,394,867		30,239,172
	TOTALI		903,857,341	473,250,421	347,674,967	85,948,857	153,660,874

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoritetit kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
3. "Vlera e financimit të miratuar për vitin 2015" tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
4. "Fonde që i reduktohen financimit" për vitin 2015, tregon vlerën e fondit të reduktuar, nga financimi për vitin 2015, për objektet që kanë ecuri punimesh nën vlerën e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo vlerë do të planifikohet për financim në vitin 2016.
5. "Fonde që i shtohen financimit për vitin 2015", tregon vlerën e fondit të shtuar, mbi financimin e miratuar deri tani me Vendime të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë vitit 2015, për objektet që kanë ecuri punimesh mbi vlerën e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo vlerë pakëson vlerën e mbetur për financim në vitin 2016.